

Delegacioni i Bashkimit Evropian shpall KONKURSIN PËR PËRKTHYES MË TË MIRË TË RI "BABILON"

Delegacioni i Bashkimit Evropian, në bashkëpunim me Shoqatën e Përkthyesve dhe interpretëve MATA, ka nderin të shpallë konkursin "Babilon 2019" për përkthyes më të mire të ri. Qëllimi i Konkursit për Përkthyes më të mire të Ri është të inkurajojë dhe të promovojë përkthyesit e rinj, si dhe të inkurajojë cilësi të shkëlqyer në përkthimin e veprave letrare nga gjuhët evropiane në gjuhët e folura në vend.

Kriteret e pjesëmarrjes:

- Tekstet e dërguara duhet të jenë përkthime të (shkëputura nga) vepra letrare: romane, novela, tregime të shkurta, apo diçka që nuk është prozë letrare.
- Tekstet e paraqitura duhet të jenë përkthime prej cilësdo nga 24 gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian në cilëndo gjuhë që flitet në vend.
- Tekstet duhet të jenë përkthime nga vepra origjinale letrare të botuara në një shtet anëtar të BE-së gjatë 3 vjetëve të fundit, në cilëndo gjuhë zyrtare të BE-së, të cilat nuk janë përkthyer plotësisht apo pjesërisht në gjuhën që ka konkurruar, deri në ditën fundit për dërgimin e aplikacioneve.
- Tekstet duhet të jenë vepra origjinale të përkthyesit dhe nuk duhet të jenë botuar më parë, plotësisht ose pjesërisht, apo të jenë pranuar për botim, përfshirë këtu botimin në internet ose vetë-publikimin, si dhe të mos jenë transmetuar në radio ose televizion. Këto tekste nuk duhet të kenë aplikuar në asnjë konkurs tjetër. Tekstet mund të jenë punë e përbashkët e një numri të pacaktuar të përkthyesve.
- Kandidatët nuk duhet të jenë më të vjetër se 26 vjeç.
- Tekstet duhet të dorëzohen me një kod, të krijuar nga kandidati dhe që përmban pesë shifra, dhe secili të dorëzohet me formular të veçantë. Çdo aplikim duhet të ketë: a) një letër motivimi, b) një formular të plotësuar në mënyrë korrekte, c) një kopje të tekstit origjinal, d) një kopje të tekstit të përkthyer, dhe e) një deklaratë të nënshkruar se teksti është përkthyer nga teksti i burimit në gjuhën origjinale.
- Teksti i burimit duhet të përmbajë emrin e autorit të vet dhe titullin, dhe duhet të përmbajë faqe me numra. Teksti nuk duhet të përmbajë asgjë që mund të identifikojë përkthyesin.
- Përkthimi duhet të ketë madhësinë e shkronjave 12 dhe të jetë shkruar me font Times New Roman, me hapësirë të dyfishtë të rreshtave. Përkthimi duhet të ketë prej 3000 deri në 5000 fjalë. Përkthimi duhet të ketë faqe me numra dhe të ketë titull, si dhe nuk duhet të përmbajë asgjë që mund të identifikojë përkthyesin.
- Përkthimet nga gjuhë të ndryshme ose zhanre të ndryshme duhet të trajtohen si tekste të veçanta. Një kandidat mund të dorëzojë më së shumti tre tekste.
- Nuk ekzistojnë kufizime për kandidatët për sa i përket nacionalitetit, vendbanimit apo statusit profesional. Në konkurs nuk mund të marrin pjesë asnjë nga organizatorët, anëtarët e jurisë ose të afërmit e tyre.
- Vendimi i jurisë është përfundimtar. Kandidatëve nuk do t'u dërgohen informata kthyesë për tekstet e dorëzuara.
- Pjesëmarrja në konkurs nënkupton pranim të të gjitha kriterëve.

Çmimet do të ndahen për të gjitha gjuhët për të cilat do të pranohen aplikime.

Çmimet përbëhen nga: Udhëtim edukativ në lidhje me përkthimin, anëtarësi vjetore në Shoqatën e Përkthyesve dhe interpretëve MATA, dhe botim i përkthimit, plotësisht ose pjesërisht, në revistën *Kulturen zhivot*.

Do të ketë juri për të gjitha gjuhët në të cilat do të dorëzohen formularë aplikimi. Procesi i zgjedhjes përfshin dy faza; kandidatët në fazën e parë do të vlerësohen nga juri dygjuhësore, më pas, kandidatët që kanë fituar minimumin e përcaktuar të pikëve do të vlerësohen nga juri njëgjuhësore. Pikët do të përmbledhen nga rezultatet të këtyre dy jurive. Juritë përbëhen nga përkthyes me përvojë nga gjuhët relevante, anëtarë eminent të akademisë, dhe/ose shkrimtarë.

Juria rezervon të drejtën të mos ndajë çmim.

Më 10 tetor 2018, në ora 16:00, në Qendrën Informative të BE-së, do të mbahet një seancë informative dhe një punëtori praktike për kandidatët potencialë dhe përkthyesit e rinj.

Ceremonia e ndarjes së çmimeve do të mbahet në Ditën Evropiane të Gjuhëve 2019, më 26 shtator 2019.

*Vizitoni linkun e mëposhtme për një rishikim të librave nga të cilat kandidatët mund të përkthejnë:
http://euc.mk/news-from-eu-2016-ns_article-babylon-best-young-translator-award-competition.nspx
<http://mata.mk/mk/category/babylon/>

AFATI I FUNDIT PËR PRANIMIN E FORMULARËVE ËSHTË: 1 prill 2019

Kandidatët duhet të dërgojnë një letër për shprehjen e interesit, formular të plotësuar dhe një kopje të letrës së njoftimit në adresën në vijim: **Babyloncompetition@euic.mk**

Më shumë informata mund të gjenden në ueb faqet e Delegacionit të BE-së, Qendrës Informativë të BE-së dhe Shoqatës së Përkthyesve dhe Interpretëve MATA

FORMULARI I APLIKIMIT

Emri dhe mbiemri i kandidatit/es/ëve (për vepra të përbashkëta duhet të shënohen emrat dhe mbiemrat e të gjithë përkthyesve):

Adresa/t permanente të kandidatit/es/ëve:

Adresa/t elektronike:

Titulli i veprës origjinale:

Gjuha e veprës origjinale:

Titulli i përkthimit:

Gjuha e përkthimit:

Autori i veprës origjinale:

Shënime të shkurtra mbi autorin e origjinalit:

Kodi:
